



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1038/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Keis” (Kosova Export Import Supply Pharmaceutical) Sh.P.K, me nr. unik identifikues 810519621, dhe me seli në Prishtinë, rr. “Velania II”, nr. 6, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat F.S. me zyre në Gjilan, kundër debitorit “Kosovo Endocrine Group” Sh.P.K, me nr. unik identifikues 811475723, me seli në Ferizaj, Talinoc i Jerlive, p.nr., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 242/23 të datës 15.06.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik F. Nuhiu nga Gjilani, jashtë seancës me datën 20.12.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Kosovo Endocrine Group” Sh.P.K, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 242/23 i datës 15.06.2023, i lejuar nga Përmbartues Privat Besnik F. Nuhiu, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ”Keis” (Kosova Export Import Supply Pharmaceutical) Sh.P.K, me datë 15.06.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 242/23, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturë nr. 1151-210-001-21 e datës 03.08.2021; Faturë nr. 1260-210-001-21 e datës 19.08.2021; Faturë nr. 1226-210-001-21 e datës 13.08.2021; Faturë nr. 1493-210-001-21 e datës 21.09.2021; Faturë nr. 1583-210-001-21 e datës 12.10.2021; Faturë nr. 1804-210-001-21 e datës 25.11.2021; Faturë nr.1890-210-001-21 e datës 09.12.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t’ia paguaj kreditorit shumën prej 2,632.96 EUR (me shkronja: dymijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy euro e nëntëdhjetë e gjashtë euro cent), si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbarimor, me arsyetimin se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor nuk janë nënshkruar nga personat e autorizuar nga debitori, sepse të autorizuar kanë qenë pronarja e kompanisë dhe drejtori menaxhues, andaj i ka propozuar gjykatës që të caktojë seancë ku do të vërtetohej fakti se nga kush janë nënshkruar faturat si dhe kush e ka pranuar mallin. I ka propozuar gjykatës që të hedhë si të pa bazuar propozimin për përmbarim.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim janë të pa bazuara, për arsye se pretendimi sa i përket nënshkrimit të faturave nuk qëndron nga fakti se pas pranimit të mallit – produktit, fatura është nënshkruar nga personi përgjegjës i cili ka evidentuar emrin e tij dhe nënshkrimin dhe është pajtuar me obligimin për të bërë pagesën sipas së njëjtës. Duke qenë se qëllimi i debitorit ka për qëllim zvarritjen e procedurës, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë si të pa bazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaket si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimit mbi bazën e dokumenteve: Faturë nr. 1151-210-001-21 e datës 03.08.2021; Faturë nr. 1260-210-001-21 e datës 19.08.2021; Faturë nr. 1226-210-001-21 e datës 13.08.2021; Faturë nr. 1493-210-001-21 e datës 21.09.2021; Faturë nr. 1583-210-001-21 e datës 12.10.2021; Faturë nr. 1804-210-001-21 e datës 25.11.2021; Faturë nr.1890-210-001-21 e datës 09.12.2021, të cilat i plotësojnë kushtet për të

qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit i vënë tek pranuesi i secilës faturë, dhe të cilat fatura i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së.

Gjykata pati parasysh deklaratimet e debitorit të ngritura në prapësim mirëpo gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t'i mbështetur pretendimet e tilla, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1038/23, datë 20.12.2023

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.